



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 224/25 Dt. 04.04.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet ftesa e Shoqatës së Festivaleve Evropiane, Festivalit Ndërkombëtar të Edinburgut, Festivalit të Edinburgut dhe Këshillit të Qytetit të Edinburgut, drejtuar kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, dhe drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Adem Morina, për pjesëmarrje në Samitin e Festivaleve të Arteve 2025, që mbahet nga data 27 prill 2025 deri me 30 prill 2025 në Edinburg të Mbretërisë së Bashkuar.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare do të bëhet me datën 26 prill 2025 dhe kthimi me 04 maj 2025, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, të akomodimit, ushqimit, për pagesë të mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës- pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet Kabineti i Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Kabinetit të Kryetarit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

